

# STATUTI I SHOQËRISË “ME-Electric”

## Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “ME-Electric” dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (me poshtë e quajtur “Shoqëria”).

## Neni 2 Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: :” Njesia Bashkiake Nr 2, Rruga Seit Bathorja, banesë private nr 6, Tiranë” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

## Neni 3 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë për shoqërinë “ME-Electric” kryerjen e veprimtarisë në fushën e ndërtimit, studimit, projektimit, supervizimit, kolaudimit, konsulencës, mirëmbajtjes, shërbimeve, turizmit, prodhimit, importeksportit, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private. Ndërtimin, prishjen dhe rikonstruksionin e godinave civile, objektet industriale, centraleve të ndryshme, objektet turistike, objektet me qëllim agroturizmin, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike etj. Ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve, autostradave, mbikalimeve, hekurudha e tramvaj, metrove e pistave aeroportuale. Ndërtimin, prishjen, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, ndërtimet e nënstacioneve, kabinetat e transformatoreve linja e tensionit të ulët, mesëm e të lartë dhe shpërndarje të energjisë, si dhe çdo ndërtim tjetër që përben send të paluajtsëm në përfundim. Import eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të Energjisë Elektrike, pajisje elektrike dhe aparatura elektronike, produkte, mallra dhe lende të para të përdorimit industrial dhe të përgjithshëm, makineri, pajisje për përdorim industrial dhe të përgjithshëm, mobilje, pajisje zyre dhe mjete informatike etj. Import-eksport dhe tregtimin e të gjitha llojeve të materialeve, makinerive paisjeve dhe impianteve të ndryshme të karakterit elektrik, elektroshtepiak, elektronik, të telekomunikacionit, të destinuara për objekte civile dhe industriale. Prodhimin e paisjeve dhe makinerive të përmendura më sipër. Kryerjen e veprimtarive të shërbimit e riparimit të karakterit elektrik elektronik të telekomunikacionit e të llojeve të tjera. Projektimin dhe zbatimin e projekteve dhenien e konsulencës, asistencës teknike dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mesipërme. Ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Punime, germime, ndërtime e rikonstruksione në objekte civile dhe industriale. Prodhimin e paisjeve dhe makinerive të përmendura më sipër. Projektimin, supervizim dhe zbatimin e projekteve dhenien e konsulencës, asistencës teknike dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mesipërme. Projektim dhe Instalim i impianteve elektrike, teknologjike, termike, hidrike, të ventilimit ftohje-

ngrohjes (kondicionimit), fumizimit me gaz, i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore,shkallelevizese, transportues), te sinjalistikes rrugore etj. Studime fizibiliteti ne fushen e ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise me promovimin e shkembimeve tregtare nga Shqiperia per jashte dhe nga jashte per ne Shqiperi.

#### **Neni 4** **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

#### **Neni 5** **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1 kuotë, i cili zotërohet si më poshtë:

Armand Bushi me pasaporte me numër personal I80310085K zotëron 1 kuotë me vlerë 100,000 lekë, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

#### **Neni 6** **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### **Neni 7** **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 8** **Mënyra e thirrjes**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë

#### **Neni 9** **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 10 të Statutit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 10** **Marrja e vendimeve**

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në paragrafin e parë të



nenit 9 të këtij statuti, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 7 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

### **Neni 11** **Administrimi**

Administrator i shoqërisë është:

- Endri Ibraliu, i datëlindjes 12.11.1994, lindur në Tirane , identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër personal J41112047B, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërritje.

Asambleja e ortakëve emëron dhe shkarkon Administratorin e shoqërisë me shumicë të zakonshme. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët i ushtrojnë kompetencat bashkë ose veç e veç.

### **Neni 12** **Kompetencat**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

### **Neni 13** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 14**  
**Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 15**

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne rastin e pikës b) Asambleja e Ortakëve merr vendim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

**Neni 16**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

**Neni 17**

**Riorganizimi (bashkimi, ndarja, shndërrimi)**

Riorganizimi i shoqërisë (bashkim, ndarje, shndërrim) do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

**Neni 18**

**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 19**

**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe




për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 20**  
**Dispozita përfundimtare**

Ky Statut u redaktua në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë nga ortakët themelues.

---

**ORTAK THEMELUES**  
**Armand Bushi.**



Tiranë, më datë 31.05..2021